



# Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

## Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63  
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: sekretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

### NJOFTIM PËR POZICION VAKANT

#### “Rregjizor/e i/e dytë / Koordinator/e”

*Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpikë, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpikë Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.*

Në kuadër të Projektit “**Ekipe Sportive 2022**”, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës “**Rregjizor/e i/e dytë / Koordinator/e**”

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talenteve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpikë. Projekti do të formojë Ekipe sportive jashtë shkollore në nivelin 9-vjecar (nga klasa e 6 – 9); në nivelin shkollë e mesme (nga klasa 10 – 12); në universitete.

#### **Detyrat e Rregjizor/e i/e dytë / Koordinator/e**

Rregjizori i dytë, nën mbikqyrjen e supervizorit të linjës, do të jetë përgjegjës për realizimin e videove dhe broadcast live si dhe për koordinimin e burimeve njerëzore për të realizuar produktet finale. Do të punojë me përmbajtjen që transmetohet në video, dhe duhet të ketë njohuri mbi aspektet teknike të krijimit të videove dhe broadcast live, me specifikisht për ato me natyrë sportive. Rregjizori ndjek hap pas hapi dhe të organizon ecurinë e projektit audio-vizual; parashikon kohëzgjatjen e xhirimeve; skenarin; përgatit vendin e xhirimit; ndriçimin dhe çdo çështje tjetër që lidhet me realizimin e një videoje apo broadcast live, si dhe zbaton detyra të tjera që mund të lindin mbi mbarëvajtjen e punës apo që i delegohen nga supervizori përkatës. Për të përmbushur objektivat e caktuara Rregjizori i dytë duhet të ketë:



# Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

## Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63  
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: [secretariat@nocalbania.org.al](mailto:secretariat@nocalbania.org.al) • <http://www.nocalbania.org.al>

### Kualifikimet dhe Eksperienca:

- Të ketë përfunduar studimet për administrim biznes/shkenca sociale apo fusha të ngjashme.
- Preferohen kandidatët që kanë një diplomë të nivelit master në një fusha të ngjashme.
- Të ketë të paktën 3-5 vjet eksperiencë për prodhimin e videove dhe realizimin e tyre.
- Të eksperiencë të mëparshme për pozicionimin e kamerave për eventet sportive.
- Preferohen njohuri të mira pune në të paktën një gjuhë të huaj, preferohet anglisht.

### Aftësi dhe kompetenca kryesore

- Të ketë aftësi shumë të mira koordinuese, organizative dhe komunikuese për të punuar në projekt dhe për të lehtësuar bashkëpunimin midis palëve.
- Të ketë aftësi rregjizoriale për xhirime live.
- Të mund të mbikqyrë xhirimet dhe montazhin e reportazheve / dokumentarëve / intervistave që do prodhohen në kuadër të projektit.
- Të zotërojë njohuri shumë të mira të "Paketës Office".
- Të ketë njohuri mbi aparaturat broadcast / kamerat bashkekohore.
- Aftësi bashkëpunuese në grup.

### Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Europass;
- Letër Interesi;
- Fotokopje të diplomave universitare;
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e aplikimit deri më date 04 Maj 2022, ora 16.00, në adresën [secretary.general@nocalbania.org.al](mailto:secretary.general@nocalbania.org.al), me subjekt: **Aplikim për pozicionin Rregjizor/e i/e dytë / Koordinator/e "Ekipet Sportive 2022"**